



United Nations
Nations Unies



International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Pénal
International pour
l'ex-Yougoslavie

PËRMBLEDHJE E AKTGJYKIMIT

(Vetëm për mediat. Nuk është dokument zyrtar)

D H O M A
G J Y Q Ë S O R E

Hagë, 29 nëntor 2012

Përmbledhje e Vendimit të Rigjykimit për Ramush Haradinajn, Idriz Balajn dhe Lahi Brahimajn

Më poshtë vijon përmbledhja e aktgjykimit shqiptuar sot prej gjykatësit Moloto:

Kjo Dhomë Gjyqësore është mbledhur sot për shpalljen e vendimit në procesin gjyqësor të tre të akuzuarve, Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj.

Në këtë seancë Dhoma do të lexojë përmbledhjen e përfundimeve të veta dhe thekson se kjo është vetëm *përmbledhje*, dhe se versioni i vetëm autoritativ i përfundimeve të Dhomës dhe i arsyeve në mbështetje të këtyre përfundimeve është Aktgjykimi, që do t'u jepet Palëve në përfundim të kësaj seance.

Tre të Akuzuarit, Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj, akuzohen për pjesëmarrje në ndërmarrje të përbashkët kriminale ose ndryshe, sipas formave të tjera të përgjegjësisë penale individuale, për krime kundër serbëve, romëve/egjiptianëve dhe shqiptarëve kosovarë, apo civilëve të tjerë, që pretendohet të jenë kryer prej tyre apo prej pjesëtarëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në objektin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në fshatin Jabllanicë, në komunën e Gjakovës, në Kosovën perëndimore, në vitin 1998 ("UÇK"). Në Aktakuzë pretendohet se u rrëmbyen gjithsej 16 shqiptarë kosovarë, serbë, romë dhe civilë të tjerë kosovarë të cilët, siç pretendohet, u mbajtën dhe u torturuan dhe trajtuan mizorisht në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Më tej pretendohet se tetë prej tyre u vranë gjatë kohës së mbajtjes së tyre prej UÇK-së. Këto pretendime përbëjnë bazën e gjashtë pikave të paraqitura në Aktakuzë për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, trajtim mizor, torturim dhe vrasje parashtruar në Nenin 3 të Statutit të Tribunalit, për të cilat akuzohen Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj. Lahi Brahimaj akuzohet për katër prej këtyre pikave të Aktakuzës.

Ky proces është rigjykim i pjesshëm. Tre të akuzuarit fillimisht u akuzuan më 4 mars 2005, në çështjen *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84, për 16 pika lidhur me krime kundër njerëzimit dhe 19 pika lidhur me shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Ramush Haradinaj gjithashtu u akuzua për një pikë shtesë lidhur me krime kundër njerëzimit dhe një pikë shtesë lidhur me shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Më 3 prill

<http://www.icty.org>

Media Office/Communications Service

Churchillplein 1, 2517 JW The Hague. P.O. Box 13888, 2501 EW The Hague. Netherlands

Tel.: +31-70-512-8752; 512-5343; 512-5356 Fax: +31-70-512-5355

2008, Dhoma Gjyqësore i shpalli Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn të pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës. Lahi Brahimaj u shpall fajtor për dy pika të Aktakuzës dhe u dënua me gjashtë vjet burgim, dhe i pafajshëm lidhur me të gjitha akuzat e tjera. Prokuroria e apeloj Vendimin e Dhomës Gjyqësore duke pretenduar se Dhoma Gjyqësore, midis të tjerash, shkeli të drejtën e Prokurorisë për gjykim të drejtë duke mos i mundësuar kohë të mjaftueshme për të siguruar dëshmitë e dy dëshmitarëve thelbësorë, dhe kërkoi rigjykim.

Më 21 korrik 2010, Dhoma e Apelit, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Robinson, miratoi pjesërisht apelin e Prokurorisë dhe shfuqizoi Vendimin e Dhomës Gjyqësore për shpalljen e pafajësisë së të akuzuarve, për disa prej pikave të Aktakuzës në lidhje me krimet që pretendohet se ishin kryen në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Dhoma e Apelit urdhëroi rigjykim të pjesshëm për këto pika. Procesi gjyqësor filloi më 18 gusht 2011. Dhoma mori dëshmitë e 56 dëshmitarëve, ndër të cilët dy dëshmitarët lidhur me të cilët u urdhërua rigjykimi.

Në Aktakuzën në fuqi pretendohet se në kohën që mbulon Aktakuza, Ramush Haradinaj ishte komandant i Zonës Operative të UÇK-së të Dukagjinit në Kosovën perëndimore dhe si i tillë ushtronte komandë të përgjithshme mbi forcat e UÇK-së në këtë zonë. Pretendohet se Idriz Balaj ishte pjesëtar i UÇK-së, vartës i drejtpërdrejtë i Ramush Haradinajt dhe komandant i njësisë speciale për ndërhyrje të shpejtë e njohur si "Shqiponjat e Zeza". Pretendohet se gjatë gjithë kohës së Aktakuzës, Lahi Brahimaj ishte pjesëtar i UÇK-së, i vendosur në Jabllanicë dhe vartës i Ramush Haradinajt. Pretendohet se Lahi Brahimaj për një kohë të shkurtër shërbeu si zëvendëskomandant i Zonës Operative të Dukagjinit dhe më pas si drejtor i financës së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

Në lidhje me gjashtë pikat e Aktakuzës për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës, Dhoma ka nxjerrë përfundimet e mëposhtme:.

Pika 3:

Më 13 qershor 1998, në rrugën midis Gjakovës dhe Klinës, ushtarë të UÇK-së rrëmbyen Dëshmitarin 6, shqiptar kosovar i besimit katolik. Ai u mbajt në objektin e UÇK-së në Jabllanicë për rreth gjashtë javë, ku u rrah vazhdimisht nga ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Nazmi Brahimaj, Lahi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj. Dëshmitari 6 u akuzua se shoqërohej me serbë dhe se ishte spiun i tyre. Më 25 korrik 1998, Nazmi Brahimaj e liroi Dëshmitarin 6 nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë. Dhoma është e bindur se janë vërtetuar akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Dëshmitarit 6. Lahi Brahimaj nuk akuzohet për këtë pikë.

Pika 4:

Më 13 qershor 1998, në rrugën midis Klinës dhe Gjakovës, ushtarë të UÇK-së nxorën nga makina e tij Nenad Remishtarin, polic serb i komunikacionit rrugor. Ai u çua në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku u rrah keqas nga Nazmi Brahimaj dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së. Të nesërmen, më 14 qershor 1998, Nenad Remishtari u nxor nga dhoma ku mbahej i burgosur në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe që atëherë nuk është parë më. Ai ende konsiderohet i zhdukur. Dhoma është e bindur se janë vërtetuar akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Nenad Remishtarit. Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë lidhur me çfarë ndodhi me Nenad Remishtarin pas nxjerrjes së tij nga dhoma në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Në këto rrethana, Dhoma konkludon se vrasja e Nenad Remishtarit nuk është vërtetuar.

Dikur nga fundi i qershorit 1998, një boshnjak dhe tre malazezë të paidentifikuar, u sollën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë ku u rrahën dhe u goditën me thikë nga ushtarë të UÇK-së në praninë e Nazmi Brahimajt dhe Hamza Brahimaj. Boshnjaku i paidentifikuar u akuzua për ndërprerje të rrymës elektrike. Dhoma është bindur se janë vërtetuar akuzat për trajtimin mizor të këtyre katër meshkujve, si dhe akuza për torturim të boshnjakut të paidentifikuar. Në mungesë të provave se tre malazezët e paidentifikuar u keqtrajtuuan me synimin e nevojshëm për torturim, Dhoma konkludon se nuk është vërtetuar akuza për torturim të tre malazezëve.

Pika 5:

Më 13 apo 14 korrik 1998, ose rreth këtyre datave, Skënder Kuqi, shqiptar kosovar, u soll në objektin e UÇK-së në Jabllanicë në vendbagazhin e makinës së tij dhe u mbajt në një dhomë të objektit të UÇK-së. Ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët Nazmi Brahimaj dhe Hamza Brahimaj, e rrahën në oborr menjëherë pas mbërritjes së tij, në praninë e Lahi Brahimajt. Të nesërmen, më 14 apo 15 korrik 1998, ose rreth këtyre datave, në objektin e UÇK-së në Jabllanicë u soll Pal Krasniqi, shqiptar kosovar i besimit katolik, i cili ishte nisur prej shtëpisë së tij në Pejë për t'u anëtarësuar në UÇK. Ai u mbajt në të njëjtën dhomë me Skënder Kuqin. Disa orë më pas, Lahi Brahimaj solli në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, Dëshmitarin 3, shqiptar kosovar, i cili u mbajt në të njëjtën dhomë me Skënder Kuqin dhe Pal Krasniqin. Që të tre u rrahën vazhdimisht në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Një dëshmitar përshkroi gjendjen fizike të Skënder Kuqit dhe Pal Krasniqit si pasojë e rrahjeve me këto fjalë: "Asnjëherë s'kisha parë dikë në gjendje më të keqe. Kam parë të vdekur dhe të vrarë gjatë luftës, por nuk kisha parë ndonjëherë njerëz në atë gjendje, në gjendje shumë, shumë të keqe", përfundon citimi. Gjatë rrahjeve, Pal Krasniqi akuzohej se ishte spiun, kurse Skënder Kuqi se kishte shumë para. Lahi Brahimaj mori në pyetje Dëshmitarin 3 dhe më pas u tha dy femrave që të ushtroheshin në rrahje me shkopinj gome mbi

Dëshmitarin 3. Dhoma është bindur se janë vërtetuar akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Skënder Kuqit, Pal Krasniqit dhe Dëshmitarit 3. Lahi Brahimaj nuk akuzohet për këtë pikë.

Më 15 apo 16 korrik 1998 ose rreth këtyre datave, pas përpjekjes së tij të pasuksesshme për t'u arratisur nga objekti i UÇK-së në Jabllanicë, Skënder Kuqi u rrah shumë keq dhe më pas u çua në spital ku edhe vdiq. Dhoma është bindur se vdekja e Skënder Kuqit ishte pasojë e (komplikimeve) të lëndimeve të shkaktuara nga rrahjet që pësoi në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Akuza për vrasjen e Skënder Kuqit është vërtetuar.

Pal Krasniqi pësoi rrahje të rënda dhe të vazhdueshme në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Dëshmitari 6 e pa për herë të fundit në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, më 25 korrik 1998. Kufoma e tij u gjet në shtator 1998, në kanalin e liqenit të Radoniqit me lëndime në kokë, trup dhe duar, të shkaktuara nga armë zjarri. Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë lidhur me rrethanat e vdekjes së tij. Në rrethana të tilla, Dhoma nuk mund të konkludojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se është vërtetuar akuza e vrasjes së Pal Krasniqit.

Pika 6:

Një ditë pas sulmit të forcave serbe kundër fshatit Grabanicë, më 19 maj 1998, ose rreth kësaj date, ushtarë të UÇK-së nxorën me dhunë Naser Likën dhe Fadil Fazliun nga një shtëpi në Zhabel. Gjatë këtij incidenti, ushtarët e UÇK-së i quajtën Fadil Fazliun dhe Naser Likën "tradhtarë". Në Zhabel, ushtarët e UÇK-së rrahën dhe shkelmuan Naser Likën dhe Fadil Fazliun. Dhoma është bindur se janë vërtetuar akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Naser Likës dhe Fadil Fazliut në lidhje me largimin e tyre të dhunshëm nga Zhabeli.

Rrjedhimisht Dhoma është bindur se janë vërtetuar Pikat 3, 4, 5 dhe largimi i dhunshëm i Naser Likës dhe Fadil Fazliut nga Zhabeli, prej ushtarëve të UÇK-së, sikundër pretendohet në Pikën 6.

Në Pikën 1 të Aktakuzës pretendohet vrasja, trajtimi mizor dhe torturimi i Ivan Zariqit, serb i Kosovës, dhe Agron Berishës dhe Burim Bejtës, romë/egjiptianë të Kosovës. Provat vërtetojnë se më 17 ose 18 maj 1998, këta tre meshkuj u nisën me qerre me kalë nga fshati Dolle në drejtim të mullirit në fshatin Grabanicë për të bluar një thes misër. Ata mbërritën në Grabanicë në të njëjtën ditë. Pas kësaj dite, ata nuk u panë më kurrë nga të afërmit e tyre. Prokuroria paraqiti dy dëshmitarë për të provuar pretendimin e saj se çfarë ndodhi pasi Ivan Zariqi, Agron Berisha dhe Burim Bejta u panë për herë të fundit nga të afërmit e tyre. Sipas dëshmisë së njërit prej këtyre dy dëshmitarëve, tre meshkujt u keqtrajtuan në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe u vranë dhe të tre të Akuzuarit morën

pjesë në keqtrajtimin dhe vrasjen e tyre. Sipas dëshmisë së dëshmitarit tjetër, në keqtrajtimin e tre viktimave morën pjesë Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj. Dëshmitari i parë ndryshoi disa herë rrëfimin e tij në disa aspekte thelbësore. Ai vazhdimisht binte ndesh me dëshminë e vet e cila u kundërshtua edhe nga dëshmi të tjera të marra në proces. Dëshmia e dëshmitarit të dytë u karakterizua nga mospërputhje dhe kundërtënie të konsiderueshme. Dhoma nuk është bindur se dëshmitë e dy dëshmitarëve ishin të besueshme. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim, Dhoma konkludon se Pika 1 nuk është vërtetuar.

Në Pikën 2 të Aktakuzës pretendohet vrasja dhe trajtimi mizor i dy meshkujve romë/egjiptianë - Ukë Rexhepaj dhe dhëndrit të tij, Nesret Alijaj, nga fshati Grabanicë. Provat vërtetojnë se më 20 maj 1998, në rrugën midis Grabanicës dhe Dollovës, persona të veshur me rroba kamuflimi me ngjyrë të gjelbër të errët dhe që flisnin shqip, ndaluan Ukë Rexhepajn dhe Nesret Alijajn, ua lidhën duart, ua mbuluan sytë dhe i futën në një makinë e cila u nis në drejtim të panjohur. Prokuroria nuk paraqiti prova të drejtpërdrejta në lidhje me çfarë ndodhi me Ukë Rexhepajn dhe Nesret Alijajn pas rrëmbimit të tyre nga rruga midis Grabanicës dhe Dollovës. Ajo mbështetet në dëshminë e një dëshmitari nga një proces tjetër, i cili nuk u mor në pyetje nga Mbrojtja lidhur me dëshminë e tij se dy burra të paidentifikuar me prejardhje rome që kishin lidhje vjehërr-dhëndër me njëri-tjetrin, ishin të pranishëm në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim, Dhoma konkludon se Pika 2 nuk është vërtetuar.

Pika 6 përmban akuza shtesë për keqtrajtimin e Naser Likës, shqiptar kosovar, në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Prokuroria paraqiti vetëm një dëshmitar në mbështetje të kësaj akuze; ky ishte njëri nga dy dëshmitarët që paraqiti Prokuroria për Pikën 1. Dhoma nuk u bind mbi besueshmërinë e këtij dëshmitari. Konkretisht, Dhoma nuk u bind se gjatë kohë së Aktakuzës dëshmitari ishte faktikisht i pranishëm në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe se faktikisht kishte parë ngjarjet për të cilat dëshmoi. Dhoma fitoi përshtypje të qartë se kishte të ngjarë që ky dëshmitar po ritregonte çfarë kishte dëgjuar nga të tjerët. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim, Dhoma përfundon se nuk janë vërtetuar akuzat për torturim dhe trajtim mizor të Naser Likës në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, parashtuar në Pikën 6.

Pretendimi qendror në Aktakuzën në fuqi është ekzistenca e ndërmarrjes së përbashkët kriminale (do t'i referohem me "NPK"), qëllim i përbashkët i të cilës ishte konsolidimi i kontrollit të plotë të UÇK-së mbi Zonën Operative të Dukagjinit përmes largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë të Kosovës, keqtrajtimit të civilëve shqiptarë kosovarë dhe romë/egjiptianë të Kosovës si dhe civilëve të tjerë që bashkëpunonin apo mendohej se bashkëpunonin me forcat serbe, apo ndryshe nuk e

përkrashnin UÇK-në. Pretendohet se NPK-ja ekzistoi nga marsi i vitit 1998, apo rreth kësaj kohe dhe së paku deri në fund të shtatorit 1998.

Prokuroria nuk paraqiti dëshmi të drejtpërdrejta për të provuar se krimet e vërtetuara u kryen në kuadër të NPK-së, pjesëmarrës të së cilës ishin tre të Akuzuarit. Dhoma shqyrtoi provat rrethanore që paraqiti Prokuroria për të provuar këtë pretendim. Në këto prova bëjnë pjesë komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të botuara në media, të cilat përmbajnë informacion në lidhje me sulme apo “masa” të UÇK-së kundër bashkëpunëtorëve të autoriteteve serbe. Dhoma konkludon se informacioni në komunikata me gjasë ekzagjerohej ose ndryshohej për qëllime propagandistike; shpeshherë ky informacion ishte i paqartë dhe nuk përmbante të dhëna për kohën dhe vendin e incidentit, për identitetin e kryesit apo të viktimës, dhe as për statusin e tyre, ushtarak apo civil. Gjithashtu, Dhoma mori dëshmi në lidhje me lista të ndryshme emrash, të cilat sipas Prokurorisë, ishin, citoj “lista të zeza të UÇK-së me emrat e personave që dyshohej se nuk ishin besnikë ndaj UÇK-së, se ishin përkrahës të partisë kundërshtare LDK, apo punonin për autoritetet serbe”, përfundon citimi. Si provë materiale është marrë vetëm një listë e tillë në formë të shënimeve me shkrim nga një takim me titull, citoj “Persona të kërkuar/ose të *zhdukur*”, përfundon citimi, qëllimi i të cilës nuk u vërtetua nga provat e tjera. Dhoma konkludon se provat e paraqitura lidhur me lista të tilla nuk mbështesin përfundimin se ekzistonte një NPK me qëllim të përbashkët kriminal, siç pretendohet në Aktakuzë.

Në pjesët përkatëse të rregullores së policisë ushtarake të UÇK-së thuhet se policia ushtarake e UÇK-së kishte për detyrë, citoj “të hetojë dhe zbulojë [...] të gjithë personat të cilët bashkëpunojnë në çfarëdo mënyre me armikun”, përfundon citimi, dhe citoj “të marrë masa kundër gjithë atyre që punojnë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, përfundon citimi. Duke marrë parasysh provat në lidhje me veprimtarinë e policisë ushtarake të UÇK-së në terren, Dhoma përfundoi se rregullat e lartpërmendura nuk provojnë ekzistencën e NPK-së.

Përveç incidenteve që ndodhën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, Dhoma konkludoi se janë vërtetuar edhe incidentet e mëposhtme të keqtrajtimit të civilëve në territorin e Zonës Operative të Dukagjinit nga ushtarë të UÇK-së: keqtrajtimi prej pjesëtarëve të UÇK-së, midis tyre Zeqir Nimonaj, Daut Haradinaj dhe Besnik Haradinaj, i Mijat Stojanoviqit, Dragosllav Stojanoviqit dhe Veselin Stijoviqit më 18 prill 1998, në kompleksin e shtëpive të familjes Stojanoviq dhe në shtëpinë e Smajl Haradinajt në Gllogjan; keqtrajtimi prej pjesëtarëve të UÇK-së i Novak Stijoviqit dhe Stanisha Radosheviqit më 22 prill 1998 në Gllogjan dhe rrahja e përkthyesit shqiptar të ekipit të ECMM-së në Gllogjan nga Idriz Balaj më 11 gusht 1998. Duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të secilit prej këtyre incidenteve, dhe në veçanti ngjarjet që ndodhën para dhe pas keqtrajtimit dhe lirimit të mëvonshëm të viktimave, Dhoma përfundon se asnjë prej këtyre incidenteve nuk tregon

rregullsi apo plan për keqtrajtimin e civilëve, siç pretendohet në Aktakuzë. Për shembull, pas një prej këtyre incidenteve, një ushtar i UÇK-së u kërkoi falje viktimave, duke fajësuar grupet e pakontrollueshme dhe ekstremiste brenda UÇK-së.

Dhoma konkludoi se Jah Bushati, Dëshmitari 6, Nenad Remishtari, një boshnjak dhe tre malazezë të paidentifikuar, Pal Krasniqi, Skënder Kuqi dhe Dëshmitari 3, u mbajtën në objektin e UÇK-së në Jabllanicë dhe u rrahën vazhdimisht nga ushtarë të UÇK-së. Dhoma konkludoi se rrahjet, me përjashtim të rrahjes së Jah Bushatit, i kryen Nazmi Brahimaj, Hamza Brahimaj, Naser Brahimaj dhe Lahi Brahimaj. Me përjashtim të Jah Bushatit dhe tre malazezëve, të gjitha viktimat e tjera u akuzuan se ishin spiunë apo se shoqëroheshin me serbë apo kishin lidhje me forcat serbe. Këto përfundime të Dhomës çojnë drejt mundësisë së ekzistencës të një plani të përbashkët ndërmjet Nazmi Brahimajt, Hamza Brahimajt, Naser Brahimajt, Lahi Brahimajt dhe ushtarëve të tjerë të UÇK-së, në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, për mbajtjen dhe keqtrajtimin e personave të cilët, për mendimin e tyre, bashkëpunonin me forcat serbe dhe nuk e përkrahnin UÇK-në. Në Aktakuzën në fuqi nuk pretendohet një plan i tillë i përbashkët dhe kjo çështje është jashtë kuadrit të këtij procesi gjyqësor. Gjithsesi, Dhoma vëren se, edhe sikur të ishte vërtetuar ekzistenca e këtij plani të përbashkët, për të cilin Dhoma ka konkluduar se nuk ekzistonte, nuk ka asnjë provë që tregon se Ramush Haradinaj apo Idriz Balaj u përfshinë një plan të tillë të përbashkët. Përkundrazi, provat vërtetojnë se kur Ramush Haradinaj mësoi për burgosjen dhe keqtrajtimin e Skënder Kuqit, ai shkoi në Jabllanicë për të biseduar me Nazmi Brahimajn në lidhje me lirimin e Skënder Kuqit, dhe i tha që, citoj “nuk duhet të ndodhë më një gjë e tillë sepse është në dëm të kauzës sonë”, përfundon citimi. Kur Dëshmitarin 3 e çuan tek Ramush Haradinaj pas arratisjes së tij nga Jabllanica dhe arrestimit të tij të mëpasshëm nga Lahi Brahimaj, Ramush Haradinaj i ofroi Dëshmitarit 3 bukë dhe strehim dhe e liroi duke e lejuar të kthehej tek familja e tij. Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë të besueshme për të vërtetuar se Ramush Haradinaj së paku kishte dijeni për krimet e kryera në objektin e UÇK-së në Jabllanicë. Në provat që pranoi Dhoma nuk përmendet askund se Idriz Balaj ishte i pranishëm në objektin e UÇK-së në Jabllanicë, apo se ai kishte dijeni për këto krime.

Pasi ka shqyrtuar të gjitha provat rrethore e paraqitura në këtë proces për vërtetimin e ekzistencës së NPK-së të pretenduar në Aktakuzë, Dhoma konkludon se nuk është vërtetuar qëllimi i përbashkët i NPK-së. Rrjedhimisht, Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj nuk janë penalisht përgjegjës për pjesëmarrje në NPK në lidhje me krimet e akuzuara në Pikat 3, 4, 5 dhe 6 të Aktakuzës. Lahi Brahimaj nuk është penalisht përgjegjës për pjesëmarrje në NPK në lidhje me krimet e akuzuara në Pikat 4 dhe 6 të Aktakuzës.

Ndryshe, Ramush Haradinaj akuzohet se urdhëroi, nxiti ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e akuzuara në Pikën 6. Dhoma përfundoi se nuk janë vërtetuar krimet e akuzuara në këtë Pikë, me përjashtim të incidentit kur ushtarë të UÇK-së larguan me dhunë Naser Likën

dhe Fadil Fazliun nga Zhabeli. Nuk ka prova që sugjerojnë e aq më pak që provojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se Ramush Haradinaj nxiti apo udhëzoi ushtarët e UÇK-së të cilët larguan me dhunë Naser Likën dhe Fadil Fazliun nga Zhabeli që të kryenin këto veprime, apo se ai ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e këtij krimi.

Ndryshe, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj akuzohen se kryen, planifikuan ose ndihmuan dhe inkurajuan kryerjen e krimeve të akuzuara në Pikën 6. Dhoma konkludon se nuk u vërtetuan krimet e akuzuara në këtë Pikë, me përjashtim të incidentit kur ushtarë të UÇK-së larguan me dhunë Naser Likën dhe Fadil Fazliun nga Zhabeli. Prokuroria nuk paraqiti asnjë provë në mbështetje të akuzave se Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj kryen, planifikuan, ndihmuan ose inkurajuan kryerjen e këtij krimi. Rrjedhimisht, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj nuk mbajnë përgjegjësi penale në lidhje me krimet e akuzuara në Pikën 6, duke përfshirë format e tjera alternative të përgjegjësisë.

Ramush Haradinaj: Ju lutem ngrihuni.

Dhoma ju shpall **TË PAFAJSHËM** në lidhje me të gjitha pikat e Aktakuzës. Dhoma urdhëron lirimin tuaj nga Njësia e Paraburgimit e Kombeve të Bashkuara pas përfundimit të formaliteteve të nevojshme, në qoftë se nuk ndodheni në paraburgim në bazë të ndonjë urdhri tjetër në fuqi për paraburgim.

Mund të uleni.

Idriz Balaj: Ju lutem ngrihuni.

Dhoma ju shpall **TË PAFAJSHËM** në lidhje me të gjitha pikat për të cilat akuzoheni në Aktakuzë. Dhoma urdhëron lirimin tuaj nga Njësia e Paraburgimit e Kombeve të Bashkuara pas përfundimit të formaliteteve të nevojshme, në qoftë se nuk ndodheni në paraburgim në bazë të ndonjë urdhri tjetër në fuqi për paraburgim.

Mund të uleni.

Lahi Brahimaj: Ju lutem ngrihuni.

Dhoma ju shpall **TË PAFAJSHËM** në lidhje me të gjitha pikat për të cilat akuzoheni në Aktakuzë. Dhoma urdhëron lirimin tuaj nga Njësia e Paraburgimit e Kombeve të Bashkuara pas përfundimit të formaliteteve të nevojshme, në qoftë se nuk ndodheni në paraburgim në bazë të ndonjë urdhri tjetër në fuqi për paraburgim.

Mund të uleni.

Këtu përfundon ky proces gjyqësor.

Seanca mbyllet.